



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Kryesia e Kuvendit

P-007
Prishtinë, më 19 janar 2015, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 19 JANAR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Jasmina Zhivković, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljeviq, Jakup Krasniqi dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari procedoi me këtë:

Rend dite

1. Kërkesa e Kryeministrit të Republikës së Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme.

Kryetari i njoftoi të pranishmit me përmbajtjen e shkresës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, që kishte parashtruar kërkesë për mbajtjen e Seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin lidhur me kërkesën e lartpërmendur të parashtruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme.

Lidhur me kërkesën e Kryeministri të Republikës së Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme diskutuan: Visar Ymeri, Donika Kada-Bujupi, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Adem Grabovci dhe Sabri Hamiti. Diskutimet e tyre janë dhënë në transkript.

Në fund, Kryesia me shumicë votash, vendosi që mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 19 janar 2015, në orën 17:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale